

**S T A T U T I**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“KAANA Build” SH.P.K.**

Sot, më datë 09.02.2024, Ortakët **Kadri BELJUL** dhe **Xhoana MERKAJ** bazuar në vullnetin e tyre të lirë themeluan shoqërinë “KAANA Build” SH.P.K., në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare”, i ndryshuar dhe vendosen të hartojnë këtë statut përfundimtar e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “KAANA Build” SH.P.K.

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 09.02.2024 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “KAANA Build”SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë jane:

**Z.Kadri BELJUL**, atësia: Enver, i datëlindjes 24.11.1995, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbajtës i dokumentit të identitetit Pasaportë me numër M0731774 dhe Numër Personal 2411995450191, lindur në Gjermani dhe banues në Shkup, Rr.“Celopek”, Nr.78, Çair, Kodi postar 1000.

**Znj.Xhoana MERKAJ**, atësia: Fatmir, e datëlindjes 15.12.1995, mbajtëse e dokumentit të identitetit me numër 032575753 dhe Numër Personal: J56215053F, lindur në Polican, Skrapar dhe banuese në Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, Rr.“Zef Jubani”, Ndërtesa Nr.8, H.5, Apartamenti 28, Kodi postar 1019.

**Neni 2**  
**Selia**

Selia juridike e Shoqërisë, ndodhet në Njësia Administrative Nr.5, Rruga: Muhamet Gjollesha, Zona Kadastrale 8270, Pasuria Nr.5/73 + 1-2/1, Nd.7, AP.2/1, Tiranë.

Shoqëria me miratimin e organeve kompetente, mund të krijojë qëndra sekondare, filiale, zyra përsaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te papercaktuar.

**Neni 4**

## Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Veprimitari në fushën e ndërtimeve civile, industriale, banesa, hotele, objekte kulti, rrugë, infrastrukturë, etj. Punime të përgjithshme në ndërtim, rikonstruktione dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, punime nëntokësore; ura e vepra arti, diga dhe tunele hidroteknike, ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje, punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime, punime të inxhinierise së mjedisit, rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të mesëm dhe të lartë dhe shpërndarje të energjisë, ndërtim i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

Import-Eksport, tregtim me shumicë e pakicë të artikujve industrialë, ushqimorë, etj. Prodhim dhe tregtim materiale inertesh e materiale të ndryshme ndërtimi si dhe lëndë drusore. Tregti të ndyshme mallrash, materiale, lëndë të para, etj. Shërbime të ndryshme për furnizimin dhe transportin e materialeve, pajisjeve dhe mallrave, etj

Gjithashtu shoqëria ka si objekt veprimitarie: shkëmbimin, blerjen, shitjen, dhëni me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të paluajtshme të veta, të të treteve ose të dhena me qera, si civile, tregtare ashtu dhe industriale, si dhe zhvillimi i te gjitha aktivitetave të lidhura direkt ose indirekt me pasuritë e paluajtshme në përgjithësi, përfshire aktivitetin e ndërmjetësimit në lidhje me pasuritë e paluajtshme. Shërbime projekti arkitektonik, konstruktiv dhe inxhinierike. Studim, mbikëqyrje, kolaudim, projektim arkitektonik, arredime, dizajnjime produkti e të tjera të ngjashme. Ofrimin e sherbimit te ndermjetësimit ne sektorin e punesimit kombetar dhe nderkombetar.

Shoqëria mund të kryeje cdo operacion tregtar, si edhe të blejë dhe të shesë ose të marrë me qera ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, të themeluara apo ne themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm më të vetin, apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## KREU II KAPITALI

### Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali fillestari i shoqërisë është 520 000 (pesëqindenjëzet mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre, si më poshtë:  
Ortakët themelues janë:

**Z.Kadri BELJUL**, është zotërues i 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 416 000 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë, që përbën 80 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Znj.Xhoana MERKAJ**, është zotëruese e 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 104 000 (njëqindkatër mijë) lekë, që përbën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpermjet emërimit të një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nga Asambleja e Ortakëve në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve perderisa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organë Vendimarrës**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte përgjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e me poshtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve per personat e permendor ne shkronjat "c" dhe "ç" te ketij nenii
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqeshet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaquesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### **Neni 9 Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkresë ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet me shkresë ose mesazh elektronik, duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes, rendin e dites dhe t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se para 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur, asambleja e per gjithshme e ortakeve nuk eshte thirrur sipas kesaj menyre, ajo mund te marre njoftime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

#### **Neni 10 Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave. Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 Te Ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te Nenit 88 te ligjit siper mendur.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite

#### **Neni 11 Marrja e Vendimeve**

Asambleja e per gjithshme e Ortakeve, vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera, si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

- c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shperblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga një i perfaquesuar i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njetin konflikt interes, ashtu sic eshte dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

#### **Neni 13 Administrimi**

Administrator i shoqërisë emërohet:

**Znj.Xhoana MERKAJ**, atësia: Fatmir, e datëlindjes 15.12.1995, mbajtëse e dokumentit të identitetit me numër 032575753 dhe Numër Personal: J56215053F, lindur në Polican, Skrapar dhe banuese në Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, Rr.“Zef Jubani”, Ndërtesa Nr.8, H.5, Apartamenti 28, Kodi postar 1019.

**Znj.Xhoana MERKAJ**, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare, me të drejtë ripërtëritje.

**Emer Mbiemer**

*Xhoana Merka*

**Nënshkrimi**

*[Handwritten signature]*

Administratori i shoqerisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakerisë.

#### **Neni 14 Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a) te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e pergjithshme ;
- b) te përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- c) te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisin dhe nënshkruej bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

- përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) te krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - e) te kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - f) te raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - g) te kryjene detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se një administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin e shoqerise ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

### **Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te percaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të percaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrate të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja

e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrate të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

#### **KREU IV VITI FINANCIAR- EKSPERTËT**

##### **Neni 16 Viti Financiar**

Viti finansiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finansiar, fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finansiar, Asambleja e Pëergjithshme e Ortakëve, miraton Llogarite vjetore të paraqitura nga Administratori, vendos për krijimin e fondit rezerve, fondeve për investime, si dhe destinime të tjera të fitimit ose humbjes së vitit ushtrimor.

##### **Neni 17 Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille. i ngarkuar nga ana e ortakeve

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit reportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore që ka.

#### **KREU V PRISHJA – RIORGANIZMI I SHOQËRISË**

##### **Neni 18 Prishja dhe likujdimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimi tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë



në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoperi ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket..

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqerisë: Baskimi- Ndarja**

Shoqëria mund te ndahet , bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se per gjithshme te Asamblese se Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjt Nr.9901 date 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në ketë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjt "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**" KAANA Build"**

Kadri BELJUL      Xhoana MERKAJ

Kadri Beljul  


Xhoana Merkaaj  
